



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017 Ref.: 533/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Kontabilitet dhe Auditim, MSc, 120 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
 - Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2019:
 - Administrim Biznesi, MSc, 120 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
 - Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, BA, 240 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Kontabilitet dhe Auditim, MSc, 120 ECTS, Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS, Administrim Biznesi, MA, 120 ECTS, dhe Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, BA, 240 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Kontabilitet dhe Auditim	MSc	120	Bekim Berisha, Hamdi Hoti, dhe Florije Govori
2	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	BA	240	Sermin Turtulla, Sejdi Sejdiu, dhe Teuta Vinca Kafexholli
3	Administrim Biznesi	MA	120	Halil Kukaj, Hysni Terziu, dhe Ajka Aljilji
4	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	BA	240	Flamur Shala, Vjollca Dibra, dhe Shkelqim Millaku

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” më 16.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Andrew Goodspeed, Dhurata Shehri, Patricia Kotnik, dhe Peeter Normak.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë